REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv / Org.Jed. 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 37 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.37**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", në mbështetje të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, konform, neni 51 pika 2.6, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës të Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR KOMPENSIMIN E KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE, TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE PËR TËRË TERRITORIN E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I. Me këtë vendim bëhet prezentimi i raportit dhe kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për tërë territorin e Komunës së Ferizajt, të zgjedhur nga data 1 Janar 2024 deri në përfundim të mandatit.

II. Për punën që do ta kryej Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, do të kompensohet, në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative, për çdo takim që do ta mbajë, për pjesëmarrje në takime konsultative, debate publike, konsultime publike me qytetarët dhe çështje tjera të caktuara me interes për komunitetin.

III. Kompensimi i Kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane bëhet nga mjetet buxhetore të Komunës së Ferizajt.

IV. Kryetari i Këshillit lokal të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, nuk mund të kompensohet apo paguhet për më shumë se 6 (gjashtë) takime brenda vitit kalendarik.

V. Për zbatimin dhe implementimin e këtij vendimi pas miratimit do të përkujdeset Kryetari i Komunës së Ferizajt, përkatësisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse / Izlazne: Date / Dana. 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 38 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 5
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.38**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe dispozitave të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme si dhe nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/202 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 datë 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.13 TË DATËS 30.12.2025 PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2026**

**I**

Me anë të këtij vendimi plotësohet ndryshohet vetëm pjesa tabelare e listës së pronave që ipen në shfrytëzim për Vitin 2026.

**II**

| Nr | Numri i parcelës | Zona Katastrale | Titullari-Pronari | Sipërfaqja m² | Qëllimi | Periudha kohore për dhënien në shfrytëzim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 626-1 | Babush i Ri | Komuna e Ferizajt | 27411 | Zonë ekonomike | Afatgjatë 50 vite |
| 2 | 145-0 | Babush i Ri | Komuna e Ferizajt | 128888 | Zonë ekonomike | Afatgjatë 50 vite |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 627/2 | Bablak | Komuna e Ferizajt | 51267 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 4 | 1064-3 | Prelez i Jerlive | Komuna e Ferizajt | 62059 | Për nevoja të Komunës-Projekt donatorë | Afatgjatë 50 vite |
| 5 | 228-2 | Prelez i Muhaxherëve | Komuna e Ferizajt | 21151 | Zonë Ekonomike | Afatgjatë 50 vite |
| 6 | 232-2 | Prelez i Muhaxherëve | Komuna e Ferizajt | 5983.4 | Zonë Ekonomike | Afatgjatë 50 vite |
| 7 | 719-0 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 49658 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 8 | 3050-4 | Greme | Komuna e Ferizajt | 3200 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 9 | 953-1 | Neredimie e Eperme | Komuna e Ferizajt | 25734 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 10 | 3619-1 | Komogllavë | Komuna e Ferizajt | 150992 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 11 | 3619-2 | Komogllavë | Komuna e Ferizajt | 5000 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 12 | 301-1 | Varosh | Komuna e Ferizajt | 11605 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 13 | 3-0 | Pojatë | Komuna e Ferizajt | 18431 | Për nevoja të Komunës-Projekt donatorë | Afatgjatë 50 vite |
| 14 | 636-0 | Bibaj | Komuna e Ferizajt | 1033 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 15 | 121-1 | Sojeve | Komuna e Ferizajt | 8379 | KOST | Afatgjatë 99 vite |
| 16 | 188-1 | Z.K. Talinovc i Jerlive | Komuna e Ferizajt | 6859 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjate 50 vite |
| 17 | 180-10 | Z.K. Talinovc i Jerlive | Komuna e Ferizajt | 6480 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | 1745-1-32-0 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | P=428.72m²<br>1=428.72m² | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 19 | 2154-1, 2155-1 | Greme | Komuna e Ferizajt | 4648<br>2633 | Çerdhe | Afatshkurtë 15 vite |
| 20 | 188-4 | Talinovc i Jerlive | Komuna e Ferizajt | 1300 | Çerdhe | Afatshkurtë 15 vite |
| 21 | 493-0 | Lloshkobare | Komuna e Ferizajt | 25617 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 22 | 614-1 | Bibaj | Komuna e Ferizajt | 14449 | Per trafo elektrike | Afatgjatë |
| 23 | 903-0 | Nekodim | Komuna e Ferizajt | 17180 | Per trafo elektrike | Afatgjatë |
| 24 | 1261-0 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 3991 | Per trafo elektrike | Afatgjatë |
| 25 | 22-2 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 84680 | Per kampus universitar | Afatgjatë 99 vite |
| 26 | 22-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41640 | Per kampus universitar | Afatgjatë 99 vite |
| 27 | 22-4 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 82537 | Per kampus universitar | Afatgjatë 99 vite |
| 28 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 42.119<br>Sip. Neto | Lokali me nr.1<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 29 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.887<br>Sip. Neto | Lokali me nr.2<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 30 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.887<br>Sip. Neto | Lokali me nr.3<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 31 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.924<br>Sip .Neto | Lokali me nr.4<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 32 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.924<br>Sip .Neto | Lokali me nr.5<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 33 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.924<br>Sip. Neto | Lokali me nr.6<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 34 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 41.924<br>Sip. Neto | Lokali me nr.7<br>Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | 2787-3 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 42.825 Sip. Neto | Lokali me nr.8 Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 36 | 2787-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 36.367 Sip. Neto | Lokali me nr.9 Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 37 | 2787-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 32.097 Sip. Neto | Lokali me nr.10 Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 38 | 2787-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 38.200 Sip. Neto | Lokali me nr.11 Nënkalimi | Pas pranimit teknik do të merr numër të veçantë |
| 39 | 2121-0 | Rahovicë | Komuna e Ferizajt | 19001 | Për nevoja të komunës- Projekt donatorë | Afatgjatë 50 vite |
| 40 | 2120-0 | Rahovicë | Komuna e Ferizajt | 61062 | Për nevoja të komunës- Projekt donatorë | Afatgjatë 50 vite |
| 41 | 343-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 16517 | Çerdhe | Afatshkurtë 15 vite |
| 42 | 3280-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 8822 | Çerdhe | Afatshkurtë 15 vite |
| 43 | 656-0 | Babush i Ri | Komuna e Ferizajt | 2654 | Zonë Ekonomike | Afatgjatë 50 vite |
| 44 | 715-2 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 10000 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 45 | 715-3 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 10000 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 46 | 714-0 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 1188 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 47 | 131-1 | Sojevë | Komuna e Ferizajt | 6845 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 48 | 708-0 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 2124 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 49 | 704-0 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 2556 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 50 | 719 - 0 | Cerrnillë | Komuna e Ferizajt | 49658 | Miniera | Afatshkurtë 15 vite |
| 51 | 473-1 | Zaskok | Komuna e Ferizajt | 7576 | Zonë ekonomike | Afatgjatë 50 vite |
| 52 | 2055-0 | Mirash | Komuna e Ferizajt | 19473 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 53 | 2816-1 | Ferizaj | Komuna e Ferizajt | 6466.4 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 54 | 1511-0 | Rahovicë | Komuna e Ferizajt | 2763 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 55 | 1510-0 | Rahovicë | Komuna e Ferizajt | 24662 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |
| 56 | 571-0 | Lloshkobare | Komuna e Ferizajt | 17133 | Afarizem, Tregëti dhe Industri | Afatgjatë 50 vite |

Pronat komunale të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2026 të Vendimit 01.Nr.13 i datës 30.12.2025, për të cilat ende nuk janë të definuara destinimet dhe mënyra e shfrytëzimit, do të vazhdojnë të mbeten në fuqi në kuadër të këtij vendimi dhe do të përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK).

**III**

Për realizimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër, Kuvendi dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 39 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.39**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR KËMBIMIN E PJESËVE TË NGASTRAVE KADASTRALE; 275-3 Z.K. GËRLICË E ULËT, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 274-2 Z.K. GËRLICË E ULËT, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

**I**

Me anë të këtij Vendimi këmbehen pjesët e ngastrave kadastrale;

- **275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët me sipërfaqe prej 252 m², pronë e Haki (Muhamet) Selimi ½ dhe Xhemile (Asan) Selimi ½ me**

- **Pjesen e ngastres kadastrale 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët me sipërfaqe prej 278 m², pronë e Komunës së Ferizajt.**

**II**

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët në pronësi të **Haki (Muhamet) Selimi ½ dhe Xhemile (Asan) Selimi ½ .** me siperfaqe prej 252 m² Z.K. Gërlicë e Ulët, kurse parcela 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët është në pronësi të komunës me sipërfaqe prej 278 m². Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

**III**

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për implementimin e projektit të zgjërimit të rrugës Varosh - Gërlicë e cila lidhet me Magjistralen Ferizaj - Kaçanik.

## IV

Këto prona të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas Vendimit të kuvendit komunal me Nr. 01. Nr. 04, datë 27.12.2024, në bazë të të cilit Vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 274-2 Z.K. Gërlicë e Ulët, pronë e komunës është vlerësuar 75,00 € për $m^2$, prona private - parcela kadastrale 275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët është vlerësuar 75.00 € për $m^2$, andaj në bazë të raportit te vleresimit të paraqitura në tabelë pronaret e paluejtshmëive me pjesë ideale prej ½ duhet te paguajnë diferencen për 26 $m^2$ në shumën prej 1950€ të vlerësuar nga Minstria e Financave.

## V

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

## VI

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Ferizaj.

## VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 40 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.40**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013 dhe nenit 6 të Ligjit për Transport Rrugor Nr.04/L-179 të datës 16.05.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR MIRATIMIN E RREGULLORËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT PUBLIK DHE UDHËTARËVE ME TAKSI.

**I**

**MIRATOHET**: Propozimi i Kryetarit të Komunës Ferizaj me Nr: 01.Nr.44/26 i datës 19.02.2026 Për Miratimin e Rregullorës për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Publik dhe Udhëtarëve me Taksi.

**II**

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktoj kriteret dhe procedurat administrative për organizimin e transportit publik, të udhëtarëve me taksi brenda territorit të Komunës së Ferizajt.

**III**

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe rregullorja në tërësij për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Publik dhe Udhëtarëve me Taksi.

**IV**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Ferizaj.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 41 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.41**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.96 TË DATES 12.05.2017.

**I**

Me anë të këtij Vendimi ndyshohet - Plotësohet pika I e nenit 1 të Vendimit 01.Nr.96 të datës 12.05.2017 ku në vend të: N.T.P "Ata Projekt" me Nr biznesit 70034213 pronar z. Tahir Jakupi, i cili ka ndërruar jetë me datë 25.05.2025 të dëshmuar sipas çertifikatës së vdekjes me numër të references 25/2025 RV/25001 të dates 29/05/2025, bëhet "ATA PROJEKT GROUP " SH.P.K me Nr. 812364842.

**II**

Pikat tjera te Vendimit nr.01.Nr.96 të dates 12.05.2017 nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

**III**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 04 / 2026
Nr.Orgv / Org.Br.: 01 42 Nr.Faqeve: 2
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.42**
**Data: 31.03.2026**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të dates 28.06.2013, nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËVE TË NGASTRAVE KADASTRALE: 702-0, 703-0, 704-0, 705-0 DHE 706-0 Z.K. BABUSH I SERBEVE PRONA PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESEN E NGASTRES KADASTRALE 737-0 Z.K. BABUSH I SERBËVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

**I**

Shpalljen Interes i Përgjithshëm – Publik, pjesët e ngastrave kadatsrale:

- 702-0 Z.K. Babush i Serbeve, me sipërfaqe prej 386 m², 703-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 156 m², 704-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 224 m², 705-0 Z.K. Babush i Serbeve, me sipërfaqe prej 167 m², 706-0 Z.K. Babush i Serbeve, me sipërfaqe prej 167 m², prona të Mifail (Idriz) Vogliqi.

**II**

Pjeset e ngastres kadastrale: 702-0 Z.K. Babush i Serbeve, me sipërfaqe prej 386 m², 703-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 156 m², 704-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 224 m², 705-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 167 m², 706-0 Z.K. Babush i Serbëve, me sipërfaqe prej 167 m², prona të Mifail (Idriz) Vogliqi Shpallen Interes i Përgjithshëm - Publik me qëllim të **këmbimit** me pjesen e ngastres kadastrale 737-0 Z.K. Babush i Serbëve me siperfaqe prej 1100 m² pronë e Komunës së Ferizajt .

**III**

Keto parcela Shpallen Interes i Përgjithshëm me qëllim të realizimit të Projektit infrastrukturor, asfaltimi i rrugës Babush-Cërrnillë-Mirash projekti i financuar nga Ministria e Infrastrukturës.

IV

**OBLIGOHET**: Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkojë vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Kembim të këtyre njësive.

V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VI

Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**